



Udhëzimi / Direktivë Order / Direktive	16-02	2022	2	viti god year
Organi / Institucioni Organi / Institutione Org. / Unit	Instit. / Instit. / Prof. No	Shërbimi / Prifog Appendix	Sasia / Kolicina Quantity	
SKM/SHCK	826/2022		113	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

Anr.1201/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën e datës 21.12.2021 me numër Anr.1201/2021 të parashtruar nga ankuesi

pa numër në Komunë të Ferizajt, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike **“Transferim”**, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.02.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**PEZULLOHET procedura administrative** e nisur sipas ankesës A.nr.1201/2021 të datës 21.12.2021 të ankuesit

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në vendin e punës “Drejtor në Qendrën Korrektuese në Lipjan, sipas Kontratës së punës të datës 03.07.2017. Me datës 24.09.2021 zëvendësuesi Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 1088, me të cilin ankuesin e transferon përkohësisht në pozitën “Drejtor në Qendrën e Paraburgimit në Prizren”, nga pozita “Drejtor në Qendrën Korrektuese për femra në Lipjan”, në të cilën ka qenë i transferuar përkohësisht me Vendimin me Nr.4397 me datë 24.12.2019.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër protokollit 1088 të datës 24.09.2021, ka parashtruar ankesë me datë 21.12.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar me numër protokollit 6243/2021 dhe ka marrë numrin rendor A.nr.1201/2021, me pretendime ankimore se transferimi i përkohshëm në pozitën “Drejtor në Qendrën e Paraburgimit në Prizren”, i është bërë kundërligjshëm dhe kërkon kthimin e tij në vendin e punës sipas kontratës së punës, duke kërkuar që të kthehet në pozitë “Drejtor në Qendrën Korrektuese për femra në Lipjan”, duke pretenduar se Vendimi i datës 24.09.2021 është nxjerre ende pa e përfunduar dy vite për përfundimin e transferimit sipas Vendimin e datës 10.04.2019 dhe të datës 24.12.2019, që ky i fundit ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2020.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 31.12.2021 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Me datë 25.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës në formë elektronike, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesë Anr.1201/2021 me numër protokoll 6243/2021 të datës 21.12.2021, e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nr. protokoll 1088 me datë 24.09.2021; Kontratën e punës të datës 03.07.2017; Vendimi nr. Protokoll 517 i datës 10.04.2019; Vendimi nr. Protokoll 4397 i datës 24.12.2019; Kërkesë nr. protokoll 1117 e datës 30.09.2021; Vendimi nr. protokoll 4350 i datës 17.12.2019; Përgjigje në kërkesë e datës 25.01.2022; Vendimi nr. Protokoll 01-2324 i datës 22.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për rivendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore si dhe ekzistojnë rrethana të reja të cilat e plotësojnë kushtin që vendimmarrja për lëndën A.nr.1201/2021 të ankuesit **pezullohet, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, sipas ankesës me numër protokoll 6243/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, të datës 21.12.2021 ka shqyrtuar lëndën e ankuesit sipas ankesës së regjistruar me numër rendor A.nr.1201/2021, mirëpo për të njëjtin objekt shqyrtimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, është pranuar ankesa me numër Anr.46/2022 e datës 21.01.2022 nga ankuesi i njëjte kundër Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike "Ndërprerjes së marrëdhënies së punës", kundër Vendimit Nr.165/2021 të datës 22.12.2021 të Ministres së Drejtësisë, që lidhet me pretendimet ankimore kundër nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll 1088 i datës 24.09.2021 për transferimin e përkohshëm të ankuesit në pozitë "Drejtor në Qendrën e Paraburgimit në Prizren" nga pozita "Drejtor në Qendrën Korrektuese për femra në Lipjan", i nxjerrë nga zëvendësuesi Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, për rastin e ankuesit i ka pranuar dy ankesa për çështjen juridike që lidhet me marrëdhënien e punës së ankuesit, atëherë ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që shqyrtimi i ankesës me numër A.nr.1201/2021 të datës 21.12.2021 të pezullohet deri në vendimmarrjen përfundimtare për ankesën me numër Anr.46/2022 nga Kolegji i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, sepse meqë kemi pranuar ankesë për ndërprerje të marrëdhënies së punës, ky rast shërben si parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore, kështu që Kolegji konstaton se në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton **se: "Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit"**, procedura sipas ankesës së datës 21.12.2021 pezullohet.

Në momentin që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës nxjerr vendim lidhur me ankesën e datës 21.01.2022 të ankuesit, atëherë do të vendos edhe për ankesën A.nr.1201/2021 të datës 21.12.2022 të parashtruar nga ankuesi.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 85 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1201/2021.**

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

*Vendimi i dërgohet:*

- Ankuesit
- Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Zëvendës Drejtoreshës së Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

